



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo



Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo

RAPORT MBI KONSULTIMIN PUBLIK TË PALËVE TË INTERESIT NR. 05/2019

08 korrik 2019

I. TË PËRGJITHSHME

Ky raport është hartuar në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012 për procedurat e konsultimit publik të palëve të interesit, lidhur me projekt-rregulloren e AAC-së, si në vijim:

Rregullore nr. xx/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr. 17/2017 për dispozitat dhe procedurat administrative në lidhje me aerodromet

Kjo projekt-rregullore ka qenë në procedurë të konsultimit publik sipas kërkesave të nenit 5, pika 5.2 e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012, përkatësisht nga data 21 qershor deri me 6 korrik 2019.

Neni 5, Pika 5.1 e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012 thotë që: “AAC-ja do të aplikojë procedura transparente për konsultimit publik të palëve të interesuara nëpërmes:

a) Metodës së pranimit të komenteve dhe vërejtjeve me shkrim me anë të mjeteve elektronike të komunikimit (adresë elektronike zyrtare) apo dorëzimit të tyre personalisht ; dhe/ose

b) Organizimit të takimeve publike me palët e interesuar”

Në pamundësi të organizimit të takimeve publike me palët e interesuara, konsultimi publik u realizua sipas pikës 5.1, a) të udhëzimit të lartëcekur.

II. KOMENTET E PRANUARA DHE PËRGJIGJET E AAC-së

Thirrjes së dërguar për konsultim publik të palëve të interesit i është përgjigjur një person, e cila ka paraqitur sugjerimet e saj nëpërmes postës elektronike zyrtare të AAC-së. Në vijim janë të pasqyruara vërejtjet/sugjerimet e pranuar në formë origjinale siç janë dërguar dhe pranuar në AAC për projekt-rregulloren e lartpërmendur, ndërsa në formë të përmbledhur janë paraqitur përgjigjet e AAC-së.

Komenti:

Nga aspekti profesional, nuk mund te komentoj meqe nuk disponoj me ekspertizen e duhur. Mirepo, nga kendveshtrimi i lexuesit, konkretisht lehtesise se kuptueshmerise, mendoj qe nese detajet (sqarimet) e CAT I, II, III A – B – C vendosen secila nen piken ku definohen kategorite perkatese do te jete me e qarte.

(Dërguar nga Vlora Gojani, Kryeshefe Ekzekutive NPQ “Aeroporti Gjakovës” Sh.A, dt. 24 qershor 2019, ora 10:39min)

Përgjigja e AAC-së

Nuk ka nevojë për ndërhyrje sepse kjo është rregullore e EASA e transpozuar.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo



Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo

III. PËRFUNDIM

Gjatë fazës së konsultimit publik të palëve të interesit lidhur me këtë projekt-rregulloren, është vlerësuar vetëm 1 vërejtje/komente me shkrim të cilat janë pranuar nga 21 qershor deri më 6 korrik 2019.

Raporti është hartuar nga:

Zyra për Çështje Ligjore të Aviacionit